

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXI, nr. 6387
E shtunë, 14 gusht 2021
çmimi 0.40 €

Deputetët munguan
mbi 400 herë në
sesionin pranveror FAQE 7



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) I JAPIN MBËSHTETJE
NISMËS "OPEN BALKAN" FAQE 4-5

'OPEN BALKAN' MERR BEKIMIN E SHBA-së, KOSOVA VAZHDON TA KUNDËRSHTOJË



Nisma për integrimin ekonomik të rajonit "Open Balkan" ka marrë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Departamenti Amerikan i Shtetit ka inkurajuar udhëheqësit rajon-

alë të kërkojnë mundësitë e shkurtimit të barrierave tregtare dhe të ndërtojnë ura rajonale bashkëpunimi që u shërbejnë qytetarëve. Pavarësisht prej thirrjeve për t'iu bashkuar kësaj

nisme, Kosova, Bosnja dhe Mali i Zi vazhdojnë ta kundërshtojnë atë. Përfaqësuesit e Kosovës kanë thënë se Kosova nuk mund të bëhet pjesë e kësaj nisme pa njohjen nga Serbia

AKTUALE



GJERMANIA SHËNOI
60-VJETORIN E NDËRTIMIT
TË MURIT TË BERLINIT F. 2

GRUBI: PO MOS TË ISHTE
OHRI, NUK DO TË ISHTE PRESPA,
AS NATO-ja F. 2

KOMUNA E GJILANIT NDAN
3 MILIONË EURO PËR
FAMILJET NË NEVOJË F. 6

EKONOMI



ROY ROZNEK: NË 'COMODITA'
PASHË SE KOSOVA ËSHTË
EVROPË DHE AMERIKË F. 8

EKONOMIA PO RIMËKËMBET
MË SHPEJT F. 8

SPORT

LIVERPOOLI E BLINDON VAN
DIJKUN F. 12

EDMOND AZEMI, ME PORTRET
GJIGANT NË PRISHTINË F. 12



**Haradinaj: Ky
sesion parlamentar
do të mbahet
mend për
shkarkime të
bordeve dhe për
rehati të familjarëve**



Tre të vdekur dhe
mbi 1 000 raste të
reja me Covid në
Kosovë FAQE 7



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.PK.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Gjermania shënoi 60-vjetorin e ndërtimit të Murit të Berlinit



BERLIN, 13 GUSHT - Gjermania ka shënuar të premten 60-vjetorin e nisjes së ndërtimit të Murit të Berlinit, i cili ka ndarë kombin në dy sisteme rivale politike dhe është bërë simbol i Luftës së Ftohtë, duke ekzistuar për 28 vjet. Presidenti gjerman Frank-Walter Steinmeier dhe kryetari i Berlinit, Michael Mueller, kanë marrë pjesë në ceremoninë e këtij përvjetori që është organizuar në Berlin. Ata kanë

vizituar vendin përkujtimor të Murit të Berlinit, ku rreth 140 persona janë vrarë nga gardat kufitare të Gjermanisë Lindore teksa kanë tentuar të ikin drejt Perëndimit. Ndërtimi i Murit ka nisur më 13 gusht 1961, kur ushtarët e Gjermanisë Lindore kanë nisur të shtrijnë më shumë se 40 kilometra tela me gjemba dhe beton, në atë që është konsideruar mbrojtje për ta parandaluar hyrjen e fashistëve

në Berlinin Lindor. Muri ka qenë 3.6 metra i lartë dhe ka rrethuar pjesën e ish-Bashkimit Sovjetik në kryeqytetin gjerman, i cili, ashtu si vetë Gjermania, ishte ndarë midis Shteteve të Bashkuara, Britanisë, Francës dhe ish-Bashkimit Sovjetik pas Luftës së Dytë Botërore. Muri është rrëzuar përmes një revolucionit në lindje, në nëntor të vitit 1989, duke hapur rrugë bashkimit të Gjermanisë.

27 persona të vdekur nga vërshimet në Turqi

ANKARA, 13 GUSHT - Të paktën 27 persona kanë vdekur si pasojë e shirave të rrëmbyeshëm që kanë shkaktuar vërshime në disa qyteza në rajonin e Detit të Zi në Turqi, ka thënë agjencia për emergjenca të premten. Kjo është katastrofa e dytë natyrore me të cilën po përballet Turqia këtë muaj. Vërshimet kanë shkaktuar kaos në provincat veriore, teksa autoritetet kanë qenë duke vënë nën kontroll zjarret pyjore në brigjet jugore.

Agjencia për emergjenca ka thënë se 25 persona kanë vdekur si pasojë e vërshimeve në provincën Kastamonu dhe dy të tjerë kanë vdekur në Sinop. Kërkimet kanë vazhduar edhe për një person të zhdukur në provincën Bartin. Vërshimet dhe zjarret, që kanë lënë të vdekur tetë persona, kanë shkatërruar dhjetëra mijëra hektarë të pyjeve. Më shumë se 1 700 persona janë evakuuar nga zonat e prekura, disa me ndihmë të helikopterëve

dhe barkave. Helikopterët kanë ulur personelin në kulmet e ndërtesave për të shpëtuar njerëzit, të cilët janë bllokuar pasi shirat i kanë bërë rrugët të paqarkullueshme. Si pasojë e vërshimeve është thënë se 330 fshatra kanë mbetur pa energji elektrike. Pesë ura janë shembur dhe shumë të tjera janë dëmtuar, ka thënë agjencia për emergjenca, derisa pamjet televizive kanë shfaqur shumë makina të shkatërruara nëpër rrugë.



Gjashtë persona vdesin nga të shtënat në Angli

LONDËR, 13 GUSHT - Gjashtë persona kanë vdekur si pasojë e të shtënave në Plymouth, në jugperëndim të Anglisë, më 12 gusht. Policia ka njoftuar se i dyshuari i armatosur është në mesin e të vdekurve. Policia në Londër ka njoftuar se dy gra, tre burra, duke përfshirë sulmuesin kanë vdekur në vendin e ngjarjes. Një tjetër grua ka vdekur pak pasi ka arritur në spital. "Të gjithë besohet se kanë vdekur nga plagët e plumbave", ka njoftuar policia. Incidenti nuk është lidhur me terrorizëm, dhe zona e sulmit është rrethuar nga policia për hetim, është thënë në deklaratë. Policia, po ashtu, i ka bërë thirrje publikut që të mos



shpërndajë fotografi të skenës së sulmit. Ligjvënësi lokal, Luke Pollard,

ka raportuar se një nga personat e vrarë ka qenë fëmijë nën 10 vjeç. "Shumica e

njerëzve janë duke u trajtuar nga plagët e tyre në spital", ka thënë Pollard.

Policia e ka përshkruar më herët sulmin si "incident serioz me armë". Një dëshmitare i ka thënë transmetuesit britanik BBC, se ajo ka dëgjuar të shtëna me armë zjarri dhe ka thënë se sulmuesi ka hyrë nëpër shtëpi dhe ka nisur të gjuajë. Ai më pas ka ikur nga shtëpia dhe ka nisur të qëllojë njerëzit në rrugë, ka thënë ajo. Plymouth është baza më e madhe detare në Evropën perëndimore, duke përfshirë nëndetëse bërthamore dhe anije të mëdha luftarake. Ky vend është po në zemër të jugperëndimit të Anglisë dhe një vend i famshëm për pushime brenda shtetit.

Grubi: Po mos të ishte Ohri, nuk do të ishte Prespa dhe NATO-ja

Shkup, 13 gusht - Të premten është shënuar 20-vjetori i Marrëveshjes së Ohrit, ku është mbajtur konferenca me temën "Përtej Ohrit", e organizuar nga Ministria për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive në bashkëpunim me Universitetin Kolumbia nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Në këtë konferencë morën

pjesë personalitete të njohura të vendit dhe përfaqësues të faktorit ndërkombëtar NATO, BE dhe ShBA, protagonistë dhe përkrahës të nënshkrimit dhe implementimit të Marrëveshjes së Ohrit. Në fjalimin e tij, zëvendëskryeministri i parë dhe ministër për Sistem Politik dhe Marrëdhënie Ndërmjet Bashkësive, Artan Grubi, në

cilësinë e nikoqirit, ka falënderuar pjesëmarrësit e kësaj konferencë që me praninë e tyre nderuan momentin historik të nënshkrimit të Marrëveshjes së Ohrit që vendosi themelet e vlerave të mirëfillta të demokracisë, barazisë dhe bashkëjetesës paqësore. Grubi ka shprehur rëndësinë që kishte nënshkrimi dhe

implementimi i Marrëveshjes së Ohrit duke kujtuar edhe sfidat që sollën deri tek ai moment historik që shpëtoi vendin. Ai ka theksuar edhe sfidat e "Përtej Ohrit" që Maqedoninë e Veriut vazhdojnë ta gjejnë të përkushtuar në rrugën e integritimit në Bashkimin Evropian. "Po mos të ishte Ohri, nuk do të ishte Prespa dhe NATO-ja", ka deklaruar Grubi.



Deputetët munguan mbi 400 herë në sesionin pranveror



EPOKA ERE **Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 13 GUSHT - Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) ka mbajtur të premten konferencë për media me rastin e publikimit të raportit të monitorimit dhe vlerësimit të performancës të Kuvendit të Kosovës gjatë sesionit pranveror 2021, e cila u karakterizua me një ritëm të ngadaltë të punës në procesin legjislativ, por me performancë më të mirë në rolin mbikëqyrës. Agnesa Haxhiu ka vlerësuar se Kuvendi i Kosovës në këtë sesion të punës ka shënuar rritje të lehtë të numrit të përgjithshëm të seancave krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar të legjislaturës së VII. Prej fillimit të kësaj legjislature janë mbajtur 23 seanca (duke përfshirë edhe seancën konstituive) prej të cilave 16 ishin të rregullta, katër të jashtëzakonshme dhe dy solemne. Në 13 raste seancat kanë vazhduar për një ditë tjetër, ndërkaq tri prej tyre nuk kanë arritur të përmbyllen për shkak të mungesës së kuorumit për t'iu dhënë epilog katër pikave të mbetura nga këto seanca. "Një problematikë që e ka përcjellë këtë periudhë të punës së Kuvendit ngjashëm si në të kaluarën janë mungesat e shumta të deputetëve në seancë, veprime këto që padyshim që kanë ndikuar në mbarëvajtjen e punimeve plenare. Sipas të dhënave të siguruar nga Kuvendi, deri në fund të muajit korrik deputetët kanë munguar plot 414 herë", ka thënë Haxhiu. Edhe Kryesia e Kuvendit është mbledhur dy herë më shpesh për

dallim nga periudha e njëjtë e vitit të kaluar duke mbajtur gjithsej 18 mbledhje, kurse komisionet parlamentare kanë rritur performancën duke mbajtur 176 mbledhje dhe gjashtë dëgjime publike (rritje prej 31 mbledhjesh dhe pesë dëgjimesh publike më shumë sesa sesionin pranveror 2020). Agnesa Haxhiu ka theksuar se ky sesion është karakterizuar me numër të ulët të ligjeve të miratuara (vetëm shtatë sosh) në krahasim me dhjetë ligjet e miratuara në të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. "Në bazë të agjendës legjislative të Kuvendit, janë proceduar 29 projektligje, prej të cilave shtatë janë miratuar, ndërsa 22 të tjerë janë në procedurë të shqyrtimit. Në anën tjetër, qeveria ka dështuar ta përbushë planin e saj legjislativ duke dorëzuar vetëm 27 projektligje nga 65 sa kanë qenë të parapara për procedim për periudhën prill-gusht. Këto vonesa kanë ndikuar drejtpërdrejt në dinamikën e punës së Kuvendit në shqyrtimin e tyre", ka thënë Haxhiu. Ndonëse në legjislaturën e kaluar ishte sfidë arritja e kuorumit edhe për ligjet bazike që kërkojnë shumicë të thjeshtë të votave, pavarësisht se kjo legjislaturë ka një shumicë të konsoliduar, mungesa e kuorumit vazhdoi. Mospjesëmarrja e opozitës në votim e ka shndërruar në sfidë kryesore të Kuvendit, arritjen e kuorumit në vendimmarrje në pikat që kërkonin 2/3 e votave të të gjithë deputetëve, siç ishte rasti me ratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare. Në mungesë të votave të mjaftueshme, dy marrëveshje ndërkombëtare u

Rekomandimet e KDI-së për Kuvendin

- Shumica parlamentare, gjegjësisht qeveria, duhet të ndërtojë një qasje bashkëpunuese me opozitën në funksion të arritjes së pajtueshmërisë për miratimin e marrëveshjeve ndërkombëtare kur dihet që deri në fund të këtij viti do të shqyrtohen edhe 14 të tilla.
- Çështja e mungesave të deputetëve do të duhej të adresohet përmes Rregullores së re të Kuvendit, ku do të parashiheshin sanksione financiare për deputetët që mungojnë në punime pa arsye objektive dhe atyre që përfitojnë mëditjet pa qëndruar gjatë gjithë kohës sa zgjasin punimet.
- Kuvendi të vendosë si detyrë prioritare në sesionin vjeshtor kompletimin e bordeve të shkarkuara pasi që shkarkimi i plotë i bordeve të atyre institucioneve i ka bërë ato jofunksionale. Ky proces duhet të kryhet në procedurë të hapur, transparente dhe konkurruese ashtu siç parasheh Kushtetuta dhe ligjet përkatëse në fuqi.
- Numri i ulët i dëgjimeve publike duhet të adresohet dhe përmirësohet, në mënyrë që ligjet e miratuara të gjejnë zbatim në praktikë. Është më se e nevojshme që komisionet parlamentare ta synojnë përfshirjen dhe konsultimin e një numri sa më të madh të aktorëve në procesin legjislativ.
- Të përmbyllet procesi i hartimit të rregullores së re të punës duke shfrytëzuar konsensusin aktual të arritur mes të gjitha grupeve parlamentare. Avancimi i rregullave të brendshme do ta ndihmonte Kuvendin për përmirësimin e performancës dhe përbushjen e mandatit kushtetues.

ratifikuan vetëm pas tentativës së tretë, ndërsa dy marrëveshje të tjera kanë mbetur në procedurë për votim në seancë pasi që për to nuk është arritur konsensusi i nevojshëm mes grupeve parlamentare. Haxhiu ka vlerësuar se një tjetër aspekt që e karakterizoi sesionin pranveror ishte procesi i shkarkimit të plotë të bordeve të institucioneve të pavarura dhe shkarkime individuale duke

nxitur mospajtime mes shumicës parlamentare dhe opozitës. Pavarësisht prej këtyre mospajtimeve, Kuvendi me shumicë votash ka shkarkuar bordet e katër institucioneve të pavarura siç janë: bordi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP), bordi i Radio Televizionit të Kosovës (RTK), bordi i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (KPMShCK), bordi i

Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave (ARH) si dhe një anëtar të bordit të KOSTT-it. Të dhënat nga monitorimi flasin për ngritje të performancës në ushtrimin e rolit mbikëqyrës në krahasim me periudhën e njëjtë të legjislaturës VII. "Mekanizmin e pyetjeve parlamentare si formë të ushtrimit të rolit mbikëqyrës e kanë shfrytëzuar 39 nga 120 deputetë përmes parashtrimit të 108 pyetjeve parlamentare drejtuar kabinetit qeveritar, apo 37 pyetje më shumë se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Nga numri i përgjithshëm i pyetjeve të parashtruara, 89 prej tyre kanë marrë përgjigje nga kabineti qeveritar ose shprehur në përqindje 82 për qind e tyre. Në kuadër të rolit mbikëqyrës, Kuvendi ka mbajtur dy interpelanca dhe pesë debate parlamentare, janë propozuar shtatë projektrezoluta, prej të cilave vetëm një ka marrë përkrahjen e Kuvendit, kurse gjashtë të tjera të propozuara nga opozita janë hedhur poshtë. Janë shënuar edhe 31 raportime të ministrave në komisionet përkatëse që, në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, është rritje prej tetë raportimeve më shumë. Ndërkaq lidhur me aktivitetet mbikëqyrëse të zbatimit të ligjeve, mbështetur në planet vjetore të komisioneve përkatëse, për këtë sesion janë planifikuar të mbikëqyrën gjithsej 11 ligje. Gjatë kësaj periudhe kohore Kuvendi ka miratuar vetëm një raport për mbikëqyrjen e ligjit, atij për Shoqëritë Tregtare të përpiluar nga Komisioni për Ekonomi", ka deklaruar Haxhiu.



SHTETET E BASHKUARA TË AMERIKËS (SHBA) I JAPIN MBËSHTETJE NISMËS “OPEN BALKAN”

‘Open Balkan’ merr bekimin e ShBA-së, Kosova vazhdon ta kundërshtojë

Nisma për integrimin ekonomik të rajonit “Open Balkan” ka marrë mbështetjen e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (ShBA). Departamenti Amerikan i Shtetit ka inkurajuar udhëheqësit rajonalë të kërkojnë mundësitë e shkurtimit të barrierave tregtare dhe të ndërtojnë ura rajonale bashkëpunimi që u shërbejnë qytetarëve. Pavarësisht prej thirrjeve për t’iu bashkuar kësaj nisme, Kosova, Bosnja dhe Mali i Zi vazhdojnë ta kundërshtojnë atë. Përfaqësuesit e Kosovës kanë thënë se Kosova nuk mund të bëhet pjesë e kësaj nisme pa njohjen nga Serbia

**EPOKA
ERE**

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 13 GUSHT - Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA) i kanë dhënë mbështetje iniciativës rajonale “Open Balkan” (Ballkani i hapur), të cilën Shqipëria, Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi e kanë themeluar në fund të muajit të kaluar. Departamenti Amerikan i Shtetit ka vlerësuar se ky vend përkrah çdo iniciativë që ka për synim forcimin e integritimit ekonomik rajonal sipas standardeve të BE-së. “Shtetet e Bashkuara me gjithë zemër mbështetin përpjekjet e vazhdueshme në Ballkanin Perëndimor për thellimin dhe forcimin përfshirës të integritimit ekonomik rajonal sipas rregullave dhe standardeve të BE-s”, ka bërë me dije

Departamenti Amerikan i Shtetit në një përgjigje për “Top Chanel”. ShBA-ja ka ftuar edhe vendet e tjera të rajonit që t’i bashkëngjiten kësaj iniciative. “Ne inkurajojmë udhëheqësit rajonalë të kërkojnë mundësitë e shkurtimit të barrierave tregtare, rritjen e konkurrueshmërisë ekonomike dhe të ndërtojnë në mënyrë të integruar rajonale dhe estetike ekonomitë që u shërbejnë qytetarëve të tyre”, ka vlerësuar Departamenti i Shtetit. Qeveria amerikane ka theksuar rëndësinë e katër parimeve mbi të cilat është ngritur dhe po promovohet “Ballkani i hapur”. Sipas tyre, një treg i përbashkët rajonal që siguron lëvizjen e lirë të njerëzve, të mallrave, kapitaleve dhe shërbimeve, është esencial për të tërhequr investime dhe energji për rritje

ekonomike.

Ditë më parë kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, u ka çuar mesazh udhëheqësve të Kosovës, Bosnjës e Hercegovinës dhe të Malit të Zi për çështjen e “Ballkanit të hapur”. Zaevi ka thënë se “Ballkani i hapur” është shprehje e vullnetit të fortë politik të Serbisë, Maqedonisë Veriore dhe Shqipërisë, derisa ka treguar mesazhin që ua ka ndarë udhëheqësve në Kosovë, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi. “Tri kombe bëjnë më shumë se një komb. Shikojeni nga kjo perspektivë. Së bashku ne mund të bëjmë shumë më tepër dhe kombet tona e dinë se si dhe duan që ne të bashkohemi për një të sotme më të mirë dhe një të nesërme më të mirë. Ky është mesazhi im për udhëheqësit e

Kosovës, Bosnje dhe Hercegovinës dhe Malit të Zi. Sa më mirë t’i shohim këto perspektiva të përbashkëta, aq më mirë për popujt tanë”, ka thënë Zaev. Sipas tij, qëllimi është që njerëzit të ndiejnë përfitimet e drejtpërdrejta ekonomike të ndihmës së shpejtë, si dhe të presin që përfitimet të vërehen shumë shpejt në buxhetin e familjes së një milion familjeve dhe në cilësinë e jetën e një milion qytetarëve.

Ndërsa lideri i Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI), Ali Ahmeti, ka vlerësuar se me këtë nismë rajonale nuk po përgatitet ndonjë ripushtim i Kosovës. “Gjërat nuk duhet të merren me emocion, gjërat duhet parë me gjakftohtësi se çka është e dobishme për Kosovën të pranohet dhe çka mund të jetë e dëmshme mos të pranohet. Nga këto nisma unë nuk shoh që përgatitet ndonjë ripushtim i Kosovës, kjo është nismë që vullnetarisht mund t’i bashkëngjiten edhe vendet e tjera të rajonit ose mund të mos i bashkëngjiten. Pra secili shtet sheh interesat e veta. Aty ku rrezikohen e kërcënohen interesat e shtetit, sigurisht që nuk i bashkëngjitet një nisme të

tillë”, ka thënë Ahmeti për “Kosovapress”.

Kosova nuk ndërron mendje, vazhdon ta kundërshtojë nismën “Open Balkan”

Pavarësisht prej thirrjeve të Shqipërisë dhe miqve ndërkombëtarë, Kosova e ka refuzuar pjesëmarrjen në këtë iniciativë. Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se nisma “Ballkani i hapur” më shumë i ngjan një Ballkani të hapur për ndikimet nga Lindja sesa një nisme për treg të përbashkët për vendet e rajonit. Sipas Kurtit, kjo nismë duhet të shoqërohet edhe me ballafaqimin me të kaluarën e Serbisë dhe të presidentit të saj Aleksandër Vuçiq. “Nuk mund të them se jam i entuziazmuar me emërtimin ‘Ballkani i hapur’, pasi që duke qenë aty kreu i Serbisë që nuk ballafaqohet me të kaluarën e shtetit të tij dhe të vetes së tij, ‘Ballkani i hapur’ ngjan më shumë si Ballkan i hapur për ndikimet nga Lindja, sidomos nga Federata Ruse, por edhe nga Kina si dhe Ballkan i hapur për autokracinë, për korrupsionin, për kriminelët e

luftës të cilët, siç e dimë të gjithë ne, vazhdojnë të jenë masivisht, jo vetëm të lirë në Serbi, por edhe jo pak prej tyre edhe në pushtet”, ka deklaruar Kurti.

Kundër kësaj iniciative janë shprehur edhe partitë politike opozitare.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka bërë me dije se integrimi i ekonomik i Ballkanit mund të ndodhë vetëm kur Serbia ta njohë Republikën e Kosovës. “Integrimi ekonomik ballkanik ka kuptim vetëm atëherë kur paraprihet nga një njohje politike - secili ndaj secilit. Serbia nuk e njeh Kosovën, prandaj kufijtë marrin edhe më shumë kuptim. Ato bëhen vetvetiu më të fortë. Prandaj dhe si heqim dot as si ‘Mini Schengen’ e as si ‘Open Balkan’”, ka thënë Abdixhiku.

Ai ka vlerësuar se Qeveria e Kosovës duhet të flasë me qeverinë shqiptare për këtë çështje. “‘Open Balkan’, para se të jetë projekt ekonomik është, megjithatë, projekt politik. Përfitimet ekonomike bëhen të

parëndësishme përballë mohimit politik serb dhe këtë duhet ta kuptojë secili i përfshirë, sidomos kolegët tanë në Shqipëri. Qeveria e Kosovës duhet të flasë gjithsesi me Shqipërinë. Tensionimi i pakuptimtë i relacioneve tona, kryesisht për shkak të interferimeve të pamatura elektorale në këtë fillimvit nga kryeministri ynë, ka bërë që për herë të parë në historinë 30-vjeçare, rrugët tona përballë Serbisë të jenë të ndara. Dhe kjo në vete është fatkeqësi. Kosova dhe Shqipëria duhet të kenë një mendim e një qëndrim. Kosova duhet të jetë pjesë e bashkëpunimeve rajonale, por vetëm si palë e barabartë, shtet sovran”, ka thënë ai.

Edhe lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se Kosova s’mund të jetë pjesë e “Open Balkan” pa njohjen e Serbisë. “Kosova e ka të pamundur që të bëhet pjesë e një nisme të tillë për shkak të mosnjohjes nga Serbia. Njohja e ndërsjellë do të krijonte mundësi që edhe



Kosova t’i bashkohet kësaj nisme, por edhe tërë bashkëpunimit rajonal. Në interes të kësaj nisme do të ishte njohja. Mendoj se në këto takime duhet të diskutohet njohja edhe nga kryeministri Rama dhe kryeministri Zaev, sepse është çështje edhe e

rajonit kjo”, ka deklaruar Haradinaj për RTSh-në.

Më 29 korrik në Shkup janë takuar kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama, presidenti i Serbisë, Aleksandër Vuçiq dhe kryeministri i Maqedonisë së Veriut, Zoran Zaev, të cilët kanë vendosur që

nismën rajonale “mini-Schengen” ta pagëzojnë me emrin e ri “Open Balkan”. Të tre liderët kanë ftuar vendet e rajonit që t’i bashkohen kësaj nisme, e cila ka për qëllim të krijojë një treg të përbashkët për vendet e rajonit të Ballkanit Perëndimor.

Tre të vdekur dhe mbi 1 000 raste të reja me Covid në Kosovë

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 13 GUSHT - Të premtën në Kosovë janë regjistruar edhe tri viktima nga Covid-19. Në njoftimin e Ministrisë së Shëndetësisë thuhet se në Gjilan janë shënuar dy viktima, ndërsa një në Gjakovë. Nga 7 424 mostra të testuara gjatë 24 orëve të fundit, pozitivë me Covid janë konfirmuar edhe 1 128 persona.

Pjesa më e madhe e të infektuarve janë të moshave nga

20 deri në 29 vjeç, përkatësisht 305 persona, ndërsa nga 30 deri 39 vjeç janë 231 të infektuar.

Sipas autoriteteve shëndetësore, nga Covid-19 janë shënuar edhe 46 persona, ndërsa raste aktive janë 5 493. Prej 13 marsit 2020, kur janë regjistruar rastet e para të infektimit, autoritetet shëndetësore në Kosovë kanë regjistruar 113 781 pacientë me këtë virus. Prej këtyre, 2 276 kanë vdekur. Sipas njoftimit, në 24 orët e fundit janë vaksinuar 19 248 persona.

Të vaksinuar me të dyja dozat janë 192 503 persona, derisa sipas autoriteteve 559 007 vaksina janë dhënë në total në Kosovë.

Qeveria e Kosovës ka miratuar të enjten masat e reja për luftim të pandemisë Covid-19. Në mesin e masave është përfshirë edhe dëshmia për vaksinim kundër këtij virusi për të hyrë në klube të natës, diskoteka, dasma dhe ahengje të tjera familjare me mbi 100 persona, nga data 20 gusht deri më 10 shtator.

Në mungesë të dëshmisë për

vaksinim duhet të paraqitet testi negativ për koronavirus jo më i vjetër se 72 orë, testi antigjen jo më i vjetër se 48 orë, ose dëshmia për tejkallim të koronavirusit brenda 180 ditëve. Dëshminë për vaksinim duhet ta kenë edhe personat që punojnë në këto biznese dhe kanë kontakt me njerëz. Bizneset do të detyrohen që të angazhojnë dikë që t’i kontrollojë dokumentet e kërkuara për të fituar qasje nëpër organizime. Personat nën moshën 18-vjeçare nuk janë të detyruar të prezantojnë këtë

dëshmi, përveç rasteve kur hyjnë në klube të natës.

Bartja e maskës është bërë e obligueshme, përveç rasteve kur një person ec vetëm në ambient të jashtëm, gjatë ngasjes së automjetit, vetëm, apo në grup me jo më shumë se katër persona, apo gjatë ushtrimeve fizike.

Shërbimet e gastronomisë do të mund të punojnë me 50 për qind të kapacitetit në ambientet e mbyllura dhe 70 për qind të kapacitetit në ambientet e hapura.

Suma takon zyrtarët e lartë të projektit të BE-së “Mbështetje reformës në Policinë e Kosovës”



HANI I ELEZIT, 13 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, ka pritur në takim pune zyrtarë të lartë të projektit të Bashkimit Evropian “Mbështetje reformës në Policinë e Kosovës”, Matt Duncan dhe Simon Smith. “Mbështetje reformës në Policinë e Kosovës” është projekt i cili zbatohet nën udhëheqjen e organizatës për bashkëpunim të jashtëm nga Irlanda e Veriut (NI-CO Northern Ireland Cooperation Overseas). Projekti i ka katër komponentë dhe një prej tyre është fusha e

parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm. Zyrtarët e BE-së e njoftuan kryetarin Suma me qëllimin e takimit dhe të projektit, i cili, ndër të tjera, ka për qëllim bashkëpunimin ndërinstitucional të trajtimit të çështjeve që lidhen me radikalizëm si dhe për t'i shqyrtuar mundësitë se si projekti mund ta ndihmojë komunën e Hanit të Elezit përmes bashkëpunimit me agjencitë e tjera relevante. Duke iu përgjigjur interesit të mysafirëve, kryetari Suma ka pohuar se çështja e

parandalimit dhe luftimit të ekstremizmit të dhunshëm është vlerësuar si shumë komplekse. “Për shumë vite e shumë herë është trajtuar në këtë zyrë dhe me shumë premtime për përkrahje mirëpo, fatkeqësisht, nuk kemi hasur në bashkëpunim të sinqertë dhe serioz, as me institucionet vendore, as edhe me donatorë e projekte të ndryshme”, ka thënë Suma. Sipas tij, kjo çështje duhet të trajtohet në shumë dimensione dhe me një bashkëpunim të të gjithë palëve përgjegjëse.

Komuna e Gjilanit ndan 3 milionë euro për familjet në nevojë

GJILAN, 13 GUSHT (ER) - Komuna e Gjilanit vazhdimisht ka mbështetur rastet me gjendje të rëndë ekonomike dhe sociale duke u krijuar kushte më të mira për të jetuar pasi që jeta i ka sprovuar me vështirësi të mëdha që nga sëmudnjt e rënda e deri te pamundësia për t'i strehuar familjet e tyre. Në kuadër të kësaj, në bazë të shifrave zyrtare, Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në Gjilan konfirmon se janë ndërtuar 163 shtëpi për familjet në nevojë me kosto financiare 2.4 milionë euro që një herë e përgjithmonë këtyre familjeve ua ka hequr brengën që kishin për strehim. Në kuadër të këtij programi janë rinovuar 49 shtëpi me kosto mbi 150 mijë

euro dhe ka paguar edhe qiratë mujore për 60 familje disa vjet me radhë me kosto 420 mijë euro. Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka thënë se solidariteti është virtyt i lartë i gjilanasve. “Shpirti i tyre human ka bërë që bashkërisht të ndihmojmë dhe për këtë në emër të të gjitha familjeve në nevojë dhe të komunës së Gjilanit jam falënderues për çdo donator që ka dhënë nga kursimet e tyre për të ndihmuar familjet me gjendje të rëndë, të sëmurit, jetimët, të moshuarit pa përkujdesje dhe kategoritë e tjera. Është numër shumë i madh i donatorëve që nga Amerika, Evropa e deri në Zelandë të Re, që iniciativën tonë e kanë mbështetur”, ka thënë Haziri.



Një qytetar në Prizren dorëzon në polici paratë e gjetura



PRIZREN, 13 GUSHT (ER) - Një qytetar nga Prizreni, Vullnet Nurkollari, ka gjetur një shumë të caktuar të hollave në rrugën “Xhevat Berisha” në Prizren. Ai menjëherë e ka njoftuar policinë dhe të hollat e gjetura i ka dorëzuar në Stacionin

Policor të Prizrenit. “Kjo shumë e të hollave deri më tani nuk dihet se kujt i takon (i ka humbur). Lusim pronarin e vërtetë të këtyre të hollave të paraqitet në stacionin policor në Prizren dhe të vërtetohet pronësia për t'ia dorëzuar ato”,

ka njoftuar Policia e Kosovës. Me këtë rast, Drejtoria Rajonale e Policisë në Prizren e ka falënderuar qytetarin Vullnet Nurkollari për gjestin human dhe shembullor me rastin e dorëzimit të të hollave të gjetura.

Nis asfaltimi i rrugës “Pavarësia” në qytetin e Malishevës

MALISHEVË, 13 GUSHT (ER) - Në kuadër të rregullimit dhe ndërtimit të infrastrukturës së përgjithshme, në veçanti të asaj rrugore, të premtën në qytetin e Malishevës, përkatësisht në lagjen Veselaj, ka filluar asfaltimi i rrugës “Pavarësia” në gjatësi prej 500 metrave. Kjo rrugë

është zgjeruar dhe bashkë me asfaltimin e saj është ndërtuar edhe trotuari. Fillimin e asfaltimit të kësaj rruge e kanë parë nga afër edhe drejtori komunal për Urbanizëm, Ahmet Morina, ai i Gjeodezisë, Bashkim Krasniqi dhe drejtori për Financa, Valon Mazreku, të

cilët janë takuar edhe me banorët e lagjes Veselaj. Drejtori Morina i ka uruar banorët për rregullimin e rrugës kryesore ku, përveç zgjerimit dhe asfaltimit, është ndërtuar edhe trotuari, si dhe janë larguar edhe shtyllat e energjisë elektrike.



Haradinaj: Ky sesion parlamentar do të mbahet mend për shkarkime të bordeve dhe për rehati të familjarëve

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 13 GUSHT - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, ka folur të premten për përfundimin e sesionit pranveror të Kuvendit të Kosovës. Haradinaj në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje, i kishte të gjitha mundësitë që përmes Kuvendit të nxjerrë ligje në dobi të qytetarëve, zhvillimit ekonomik të vendit e shumë çështje të tjera me rëndësi.

Ai ka thënë se ky sesion parlamentar do të mbahet mend më së shumti për tri gjëra: Për mosmiratimin e rezolutës në mbështetje të Marrëveshjes së Uashingtonit, shkarkimet e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura dhe për rahatimin e familjarëve. "Por, ky sesion parlamentar do të mbahet mend më së shumti për tri gjëra: 1. Mosmiratimin e rezolutës në mbështetje të Marrëveshjes së Uashingtonit, që është edhe akti i parë anti-amerikan në historinë parlamentare të Kosovës. 2.



Shkarkimet e bordeve të ndërmarrjeve publike dhe agjencive të pavarura dhe emërimi në to i familjarëve dhe të afërmeve të ministrave dhe deputetëve, si dhe eksponentëve të lidhur me partinë

në pushtet. 3. Nga 193 ligje të parapara me agjendën e qeverisë, vetëm 4 janë miratuar nga Kuvendi me shumicë stabile, sepse ata u shpërqendruan me rehatime të familjarëve, duke lënë anash

detyrën për të cilën ekskluzivisht janë zgjedhur nga qytetari i Kosovës. Korrupsioni dhe nepotizmi janë kancer i një shoqërie, por kur vidhet shpresa e qytetarit, është edhe më tragjike",

ka thënë Haradinaj.

Të enjten Kuvendi i Kosovës ka mbyllur sesionin pranveror të punimeve, duke shkuar kështu zyrtarisht në pushim, për t'u kthyer në shtator, në sesionin vjeshtor.

Bejtullah Deliu, kandidat i PDK-së për kryetar të Rahovecit



RAHOVEC, 13 GUSHT (ER) - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, ka bërë me dije se kandidat për kryetar të Rahovecit nga kjo parti do të jetë Bejtullah Deliu. Krasniqi në një shkrim të publikuar në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se Bejtullahu e njeh mirë Rahovecin, djersën e fermerëve, ndërmarrësve dhe pritjet e të rinjve të kësaj komune. "Rahoveci, qyteti i punës, i konakut e krenarisë, nga tetori do të ketë kryetarin që e meriton. Bejtullah Deliu është kandidati ynë për të drejtuar këtë qytet, që është zhvilluar shumë me qeverisjen e PDK-së, por ka ngecur në vitet e fundit.

Bejtullahu e njeh mirë Rahovecin, djersën e fermerëve, ndërmarrësve dhe pritjet e të rinjve të kësaj komune. Prandaj, ai ka edhe vullnetin e madh që të sjellë transformime në këtë qytet, ashtu siç e meriton. E vizitoj shpesh Rahovecin. Jam krenar me punët e mira që kemi bërë për këtë qytet. Por e di që na presin edhe shumë angazhime të tjera. Me një ekip të shkëlqyer të kandidatëve për Asambleenë Komunale, me profesionistë të ndershëm, të rinj e të reja, qytetarët e Rahovecit kanë mundësinë që me Bejtullah Deliu dhe PDK-në t'i rikthejnë punët e mira në qytet e fshatra", ka thënë Krasniqi.

Ministria e Shëndetësisë ia dhuron një autoambulancë komunës së Prizrenit

PRIZREN, 13 GUSHT (ER) - Zëvendësministri i Shëndetësisë, Arsim Berisha, ia ka dorëzuar të premten një autoambulancë të re, të dhuruar nga Ministria e Shëndetësisë, kryetarit të komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka. Kjo autoambulancë ka të gjitha kushtet dhe pajisjet e nevojshme për ofrimin e

ndihmës së shpejtë. "Para marrjes së mandatit, në shërbim të qytetarëve të Prizrenit ishin vetëm tri autoambulanca, ndërkaq tani janë shtuar edhe shtatë të tjera, duke çuar kështu numrin e autoambulancave në dhjetë, e cila mundëson intervenim shumë më të shpejtë në rastet urgjente që paraqiten.

Jam shumë i lumtur me punën që po bëhet në shëndetësi. I kemi përmbushur të gjitha premtimet tona dhe po vazhdojmë përtej premtimeve. Falënderoj Ministrinë e Shëndetësisë për mbështetjen dhe Drejtorinë e Shëndetësisë për punën", ka thënë kryetari Haskuka.



Roy Roznek: Në 'Comodita' pash se Kosova është Evropë dhe Amerikë

GJAKOVË, 13 GUSHT (ER) - Pas amerikanëve, gjermanëve, austriakëve, norvegjezëve e shumë mysafirëve të tjerë, "Comoditën" e ka vizituar edhe zëvendës-presidenti i Odës Ekonomike të Izraelit, Roy Roznek. Ai ka theksuar se nuk përtoi fare t'i bëjë gati 2 000 kilometra për ta parë fabrikën për të cilën tha se po e përmendin të gjithë kur bëhet fjalë për cilësinë e padiskutueshme të dyshekëve. Pasi u prit nga aksionari dhe stafi menaxherial i "Comoditës", Roznek ka lëvdur ata dhe punëtorët për profesionalizmin, përkushtimin si edhe për pastërtinë në ambientet brenda dhe përreth fabrikës. "Këtu pashë se Kosova është ndryshe nga ajo

që njihja më parë. Pashë se Kosova është Evropë, është Amerikë. Kjo vërehet në këtë fabrikë, vërehet te menaxhmenti, punëtorët dhe te gjithë tjetër", ka deklaruar ai.

Roznek ka paralajmëruar thellimin e bashkëpunimit në mes të firmave izraelite me "Comoditën", por edhe me biznese të tjera të korporatës ku bën pjesë kjo fabrikë, sikur edhe të krejt Kosovës. "Këto fabrika do të bashkëpunojnë me kompanitë izraelite. Mund t'ju them se ky është vetëm fillimi i këtij bashkëpunimi që nuk do të jetë i vetmi", është shprehur Roznek. Bashkëpunimi i "Comoditës" me bizneset izraelite nisi para pak ditëve. Fabrika e më e madhe në




Kosovë ka eksportuar prodhimet e para të veta në Izrael dhe, siç thanë drejtuesit, mallrat që nisën në shtetin e zhvilluar, u pritën shumë mirë nga klientët e atjeshëm. "Kemi marrë shumë komplimente për produktet dhe gjithë tjetër rreth këtij procesi", ka pohuar Granita Bunari, drejtoreshë operative në "Comodita Home". "Comodita Home" prodhon 2.5 milionë dyshekë në vit, 600 mijë

mbishtresa dysheku dhe 2.5 milionë jastëkë në vit. Në këtë fabrikë thonë se janë eksportuesi më i madh në Kosovë, ndërsa shtojnë se prodhimet e tyre plasohen në tregje të mëdha si në ShBA, Kanada dhe shumë vende të Evropës. Në dy-tre muajt e fundit "Comodita" është bërë stacion i pashmangshëm i vizitave të shumta të politikanëve, diplomatëve dhe afaristëve të huaj.

Pothuajse të gjithë, pa përjashtim, kanë lavdëruar aksionarin dhe stafin menaxherial që po bëjnë përpjekje të mëdha për të krijuar vende të shumta pune dhe për të kontribuar në buxhetin e shtetit. Po ashtu, ata kanë përmendur edhe faktin se krejt këto ndikojnë pozitivisht që rinia dhe profesionistët të mbeten në Kosovë, duke pamundësuar kështu ikjen e trurit jashtë vendit.

ATK-ja: Përfitoni nga pakoja e ringjalljes ekonomike



PRISHTINË, 13 GUSHT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), duke u bazuar në vendimin e qeverisë lidhur me pakon e ringjalljes ekonomike, ka zhvilluar aplikacionin në mbështetje të punësimit të grave dhe tashmë punëdhënësit mund t'i parashtrijnë kërkesat e tyre për të përfituar nga këto masa. ATK-ja ka njoftuar se të drejtë aplikimi kanë shoqëritë tregtare të regjistruara dhe punëdhënësit sipas legjislacionit të Kosovës. Po ashtu, ATK-ja sqaron se aplikimi bëhet përmes Sistemit Elektronik EDI të Administratës Tatimore të Kosovës përmes formularit të veçantë që

është i qasshëm në EDI. Sipas ATK-së, përmes Sistemit Elektronik EDI punëdhënësit kanë mundësi të aplikojnë për të përfituar nga masat e pakos së e ringjalljes ekonomike. "Masa 1.1: Rikthimi në punë i atyre që kanë humbur vendin e punës gjatë pandemisë; Subvencionim i pagës deri në 50 për qind të pagës mujore bruto për tre muaj. Masa 1.2: Mbështetja për të punësuarit e formalizuar. Subvencionim i kontributit pensional në vlerë prej 10-përqindësh të pagës bruto mujore për më së shumti 12 muaj, duke filluar nga muaji korrik 2021 deri në muajin qershor 2022, dhe masa

1.3: Mbështetja e punësimit të grave. Subvencionim i pagës deri në 50 për qind të pagës bruto mujore për tre muaj, ndërsa pas përfundimit të periudhës tremujore subvencionohen kontributet pensionale për muajt e mbetur, konform kriterëve dhe kufizimeve të përcaktuara me vendimin për zbatimin e masës 1.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike të Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve nr. 40/2021, të datës 29 korrik 2021", thuhet në njoftimin e ATK-së. Po në njoftim thuhet se aplikimi është i hapur nga sot dhe deri më 15 tetor 2021 në orën 24:00.

Ekonomia po rimëkëmbet më shpejt

TIRANË, 13 GUSHT (ER) - Ekonomia në Shqipëri do të rimëkëmbet më shpejt se parashikimet këtë vit, pas goditjes që mori një vit më parë nga kriza e pandemisë si rrjedhojë e karantinës tremujore dhe masave të tjera kufizuese. Këto janë pritshmëritë e Bankës Qendrore të evidentuara në

raportin tremujor të politikës monetare. Sipas Bankës Qendrore në Shqipëri, ndikim në rikuperimin më të shpejtë se pritshëmritë ka dhënë sektori prodhues, ai shërbimeve si dhe energjisë elektrike. "Ecuria pozitive e treguesve të ekonomisë në tremujorin e parë dhe përmirësimi i besimit në

ekonomi krijojnë premisa për norma më të larta të rritjes ekonomike edhe në tremujorin e dytë", thuhet në raportin e Bankës Qendrore të Shqipërisë. Me gjithë parashikimet optimiste, Banka Qendrore ka vlerësuar se përhapja e varianteve të reja të virusit Covid mund ta rrezikojë ekonominë e Shqipërisë.





GEVERINA MUZHAQI

HIJA E MALIT

Një hije e rëndë mbulonte fshatin. Ndonëse ishte mesditë dhe dielli i shtrinte bujarisht rrezet tejmbanë, fshati jetonte në errësirë të përhershme. Fshatarët, të mësuar me këtë klimë mendore e jo vetëm, me sa dukej ishin dorëzuar e nuk ia vinin më veshin asaj errësire të ditë-natshme që s'e lejonte rrushin të piqej sa duhej e t'u jepte raki të mirë në tryezë e që nuk premntonte prodhimtari të shëndetshme të frutave e perimeve që ata t'i çonin në tregun e qytetit. Teshat e ndera thaheshin me vështirësi në telat sipër tarracave të shtëpive dhe shumë shpesh, edhe në periudha të ngrohta, re të zeza e shkarkonin gjithë inat shiun në kokat dhe çatitë e fshatarëve. Jeta aty rridhte gjithnjë njësoj. Banorët e fshatit nuk e njihnin harenë që çelte në sytë e fëmijëve me shpërthimin e sythave të para të luleve pranverore. Nuk e njihnin melankolinë që shkaktonte ardhja e vjeshtës. Ata njihnin vetëm amullinë që derdhte mbi ta hija gjigante dhe e frikshme e malit, që u qëndronte mbi krye si të ishte një përbindësh që ua këqyrte jetët, u hynte në shtrat, ulej në tryezë. Ata e ndienin praninë e hijes dhe, të dorëzuar, ishin mësuar që ta pranonin atë. Ata ishin shumë të vegjël përpara malit dhe nuk kishin asnjë pushtet mbi të, asnjë forcë për t'iu kundërvënë apo për t'u zhvendosur në ndonjë fshat tjetër atypari.

"Sa kushtojnë mollët?" - e pyeti gruaja e bëshme, veshur me fustan

të gjelbër, që kishte zbritur nga makina e të shoqit për të blerë fruta ndanë rrugës.

"Njëqind e shtatëdhjetë lekë", - iu përgjigj Aliu, fshatari që i shiste.

"Njëqind e shtatëdhjetë këto mollë?" - pyeti me mospëlqim gruaja.

"Po, njëqind e shtatëdhjetë", - përsëriti Aliu, pa u prekur aspak nga habia e gruas. Hija e malit kishte pushtuar edhe tiparet e fytyrës së tij.

"Këto?" - këmbënguli zonja dhe u mrrrol në fytyrë.

"Këto", - ia ktheu Aliu, pa e vënë shumë ujë në zjarr.

"Mor zotni, a e dini ju se në qytet i gjen shumë herë më të mira e më të lira? Këto duken si të pabëra".

"Atëherë kthehuni e blijini në qytet", - ia priti fshatari dhe vazhdoi t'i pastronte thonjtë me kunjat e dhëmbëve.

Thonjtë e tij të nxirë dhe, mbi të gjitha, sjellja prej fshatari të pagdhendur e Aliut, bënë që gruaja e veshur mirë e me pamje spitullaqe, që vinte nga qyteti, të lëshonte një ua me pamje të habitur e të kthehej duarbosh në makinën e të shoqit. Vetëm pasi e mbylli derën e makinës, gruaja e sylli Aliun e i tha si nëpër dhëmbë gjithë përçmim: "Katunar i dreqit!".

I shoqi i dha gaz makinës dhe rruga mbeti sërish e shkretë.

"Shko, shko bli ato frutat gjithë ilaçe, që t'i shesin në qytet, moj budallaqe e gjorë", i bërtiti fshatari gjithë mllef, por gruaja tashmë ishte larg dhe nuk mundi ta dëgjonte. Pastaj vështroi kokrat e mollëve të

radhitura njëra pas tjetrës dhe mendoi se, po të ishte sjell ndryshe me zonjën e qytetit, tashmë do të kishte në tezgë një a dy kile mollë më pak e ca të holla më tepër në xhep. Por pastaj e shtrembëroi fytyrën shpërfillëse dhe i tha vetes se nuk mund të nxirret dhjamë nga pleshti. Punë e bukur fort. Më mirë t'i hante vetë mollët apo t'ia hidhte kalit që t'i hante apo, fundja fare, më mirë t'i linte të kalbeshin sesa ta ulte hundën përpara asaj spitullaqes trashaluqe.

Andaj vazhdoi t'i pastronte thonjtë e të fishkëllente një këngë popullore të krahinës së vet. Ah, sa bukur që e kishin kënduar atë këngë ditën e dasmës së tij! Ai mbante mend vetëm një ditë të lumtur në jetën e tij: ditën kur ishte martuar. Sikur, vetëm për atë ditë, mali t'ia kishte dhënë lejen që ta ndryshonte humorin e ngahershëm e të ndihej cazë i lumtur.

Nusen ia kishte gjetur daja i tij nga një fshat jo shumë larg prej aty dhe ai sa nuk po plaste nga dëshira për t'u martuar sa më parë e ta shijonte trupin femëror të nuses së re në shtëpizën e vet në fshat. Nusja ishte thatime, por ishte punëtore, kishte urtësi dhe ëmbëlsi kur buzëqeshte dhe ai nuk mund të kërkonte më shumë.

Ajo kishte vetëm një problem: ishte mësuar me diellin e fshatit të saj.

Qysh në ditët e para pas martesës, ëmbëlsia e buzëqeshjes sikur kishte nisur t'i fashitej dhe ajo

vazhdonte të humbte peshë gjithnjë e më shumë. Por i shoqi nuk dukej i shqetësuar. Ai e dinte se ishte vetëm çështje kohe. Të gjithë, në fund, i dorëzoheshin pushtetit të malit. E çuditshme se si ai mal e pengonte diellin të binte mbi fshat. Po ç'kishte me fshatin, xhanëm? Sado që dielli orvatej ta zgjaste kokën e të shfaqej në ndonjë të çarë të qiellit, mali, si për inat, ia kthente shpinën dhe e pengonte diellin të shfaqej me gjithë hijeshinë e tij.

"Po ç'ke bërë, mor të shpëlaftë mortja!", iu hakërrye e shoqja duke qëndruar e ulur e duke i përplasur pëllëmbët në kofshët e saj të holla.

"Po tani, ç'do të hamë, kokëtrashësinë tënde? Katunar i dreqit!"

Aliu vuri buzën në gaz dhe ia ktheu: "Njësoj jeni ju, shejtanka. Edhe ajo, qytetarja që më shiste mend, kështu më tha".

"Po ç'pata unë që erdha në këtë fshat, more aman! Këtu të gjithë rrinë turivarur. Madje këtu edhe mali rri turivarur".

Aliu, porsa dëgjoi të shqiptohej fjala "mali", brofi më këmbë, sikur befaz dikush ta kishte pickuar.

"Shshshst...", - i tha së shoqes dhe iu afrua vulltas, me gishtin tregues në buzë. "Mos fol më, se të dëgjojnë".

E shoqja pa një herë majtas e një herë djathtas, pastaj i pëshpëriti në vesh: "Kush do të më dëgjojë?"

I shoqi e kapi nga krahu dhe e afroi te dritarja.

"Ai", - i tha dhe i tregoi me gisht malin.

E shoqja vështroi malin, sikur të kërkonte një shpjegim prej tij, mandej pa të shoqin me sy të çapëlyer.

"E po, që ishte i çuditshëm, këtë e kisha kuptuar që herën e parë kur erdhe në fshatin tim që të më njihje. Por që të ishte edhe i marrë, tani po e marr vesh".

"Boll, moj budallaqe, se do të hysh në gjynah. Mos e ngrit zërin se pastaj na piu e zeza. Ne nuk i dalim dot kundër. Thonë që gjërat kanë ndryshuar dhe se tani e kemi lirinë e fjalës. Por të pasurit vazhdojnë të bëhen edhe më të pasur dhe katunarët po katunarë mbeten. Ndërsa ai...", dhe tregoi përsëri malin, "mbetet gjithnjë më i fortë se ne. Shiko se sa i lartë është! Shiko se sa i rrezikshëm".

Dhe atëherë e shoqja e kuptoi.

Nuk ishte mali që bënte hije mbi ta, por ishte diçka edhe më e fortë dhe e tmerrshme. Diçka për të cilën i shoqi, i gjithë fshati, fshati i saj, qyteti, qytetet e tjera, madje e gjithë Shqipëria e varfër dhe e vogël, tashmë e kishin kuptuar: jetonin në një klimë të lagësht e të plogësht mendore për shkak të hijes që zgjatej mbi ta. Për shkak të asaj hijeje të përbindshme që ata e votonin çdo katër vjet. Për shkak të pushtetit. Për shkak të premtimeve. Për shkak të mpakjes së shpresës. Kaq molepsëse, kaq prangosëse e kaq të trishtat ishin të gjitha këto! Sa ai mal që u bënte hije...

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")



ADIL OLLURI

VDEKJA E AUTORIT

Zoti R. R., shkrimtar i panjohur dhe aspak i rëndësishëm për qytetin tonë, u gjet i vdekur të premten e një mesdite janari. I gjakosur kokë e këmbë e kishte takuar vdekjen, për të cilën kishte shkruar sa e sa vepra. Ai nuk e kishte pasur ndërmend të vdiste, së paku jo në orët e mesditës, kur shkruante dhe trillonte ngjarje koti, kur zakonisht dikush vdiste. Por, ja që ajo me të cilën tallej me penën e tij ishte shfaqur përnjëmendtë.

Një orë para se të ikte përfundimisht nga kjo botë i kishte rënë në gjysmë shkrimin të një novele. E mendonte si veprën më të mirë që kishte shkruar dhe që do ta shkruante ndonjëherë. Priste çmime dhe vlerësime nga ajo. Por, kishte ngecur në gjysmë të saj. Fajet i kishte një nga personazhet e tij, i quajtur K. K. Ai ishte i padisiplinuar dhe kishte sjellje jokorrekte me personazhet e tjera. I fyente dhe i poshtëronte. Fliste pa nevojë. Hynte ngado dhe dilte kudo. Ishte bërë i bezdisshëm për ecurinë e rrëfimit. Thjesht, ishte një qenie egoiste, që dëshironte me çdo

kusht të ishte personazhi kryesor i novelës. Autori nuk ia kishte dhënë këtë rol dhe tentimet e K. K. për të lëvizur vend e pavend vetëm sa e dëmtonin veprën.

- Novela që jam duke e shkruar do të jetë vepër e përtej veprës, - i kishte thënë në një mëngjes të ftohtë një shkrimtari tjetër. Ai sikur të gjithë shkrimtarët e tjerë të qytetit tonë, që ia bëjnë rrafsh njëri-tjetrit, pa ia lexuar as dhe një rresht bashkë-biseduesit, ia kishte miratuar me pikë e presje ato që R. R. i thoshte. Thënë të drejtën, pritshmëri të madhe për novelën nuk kishte askush, pos autorit të saj.

R. R. ngazëllehej me atë që shkruante. Fluturonte nga gëzimi me situatat e krijuara. I dukeshin të jashtëzakonshme e të papara nga lexuesi (lexuesi = qenie e shpërngulur moti nga këto vise). Thoshin se ai (që qytetarët ishin marrë vesh ta quanin lexues) ishte sikur një shpend shtegtar dhe shpeshherë ikte në vende të ngrohta. Gojët e hallkut gjenin lloj-lloj arsyesh të këtij migrimi, por nuk është rendi e as nuk

kemi kohë që t'i përflasin. Fundja, gojët janë për të folur, veshët për të dëgjuar e sytë për të shikuar (sa për kureshtje të atyre që ndonjëherë mund të takohen me këtë rrëfim pa ndonjë vlerë arti, është e udhës që t'u dëshmojmë se autorit real të këtij tregimi i pëlqejnë shumë gojët e hallkut. Madje-madje, ai sot me sytë e vet e ka parë një gojë të bukur dhe me veshët e tij e ka dëgjuar një përshëndetje që dilte nga kjo gojë e bukur. Vazhdimin e këtij rrëfimi kllapor (rrëfim që zakonisht vendoset në kllapa, që mund të shkruhet edhe në gjendje kllapie) do t'ju thoshim me gjithë qejf, por nuk do të na lejonte ai që dijetarët janë marrë vesh ta quajnë autor real).

Gojët e hallkut, ato që jo rastësisht kishin qëlluar të liga, shpiknin lloj-lloj arsyesh rreth vdekjes së autorit që e përçmonin. Dikush thoshte se ka gjasë që të ketë qëlluar i dehur dhe të jetë rrëzuar shkallëve të ndërtesës shumëkatëshe ku nuk ndodhej banesa e tij. Tjetri hamendësonte se do të ketë vdekur i zënë në punë, që ky i

cilësonte si të pandershme për një intelektual (nuk ka dreq që e merr vesh pse njerëzit e këtij qyteti janë të bindur se intelektualët nuk bëjnë dhe nuk duhet të bëjnë aso punësh që janë marrë vesh t'i quajnë të pandershme). Bazuar në këto kallëzime të hallkut, një hetues policie gati sa e shkroi në defterin e vet këtë fjali: Vrasje me motive të ulëta (është jashtëzakonisht e paqartë pse policët e cilësojnë seksin me epitetin: motiv i ulët). Por, e vërteta ishte krejtësisht ndryshe.

Lajmin e pretenduar për të saktë, por të besueshëm për të gjithë qytetarët, e dha një gazetë ditore që dilte nga shtypi në orën katër e gjysmë të mëngjesit. Qe një artikull i gjatë, i vendosur cep me cep në faqen trembëdhjetë të gazetës, e rezervuar për shkrimet e gazetarit A. A., që merrej në vazhdi-mësi me zbulimin e vdekjeve që e befasonin qytetin. Mendja e tij e turbullt i cilësonte si vdekje të ngutshme e të paarsyeshme. Konstatimit të tij nuk kemi se çka t'i shtojmë. E lëmë që ta gjykoni vetë, të dashur lexues, nëse gjendeni

diku (autori real mund të jetë i vrazhdë në komentimin e shkrimeve të tilla dhe mund ta shajë keqas gazetarin A. A., andaj kemi vendosur që ta kursejmë dhe të mos ia japim rastin që të fëlliqë me gojë siç do të kishte dëshirë).

Gazetari A. A. ishte i bindur se autori i parëndësishëm kishte një ves tejet të padinjitetshëm. Kishte një ves jashtëzakonisht të pakuptimtë për kureshtarët derisa ai gjallonte mes nesh se vdekja ende nuk na ka trokitur në derë, duke na lënë të besojmë se atë e kemi shtyrë për një ditë tjetër. "Zoti R. R., autor i pavënë re nga frymorët, u bë i famshëm me vdekjen e tij". Kështu e titullonte shkrimin sojsëzi. E fillonte duke na treguar se zoti R. R. javën e ardhshme do ta festonte gjashtë-dhjetëvjetorin e lindjes dhe se një shoqatë e papërfillshme shkrimtarësh kishte menduar t'ia organizonte një tryezë në nderim të punës së tij, që zotërinjtë shoqatistë e cilësonin kolosale por që, pos atyre, s'e kishte vërejtur kush. Gazetari A. A. ndante bindjen se zoti R. R. ishte pervers dhe i qe

fiksuar masturbimi para dyerve të banesave të grave që i adhuronte. Gazetari e thoshte me siguri të plotë se do të jetë parë nga dikush dhe do të jetë rrokullisur shkallëve të katit të tretë të ndërtesës për ta përqaftuar vdekjen në katin e mëposhtëm. Ndaj këtij artikulli kishin reaguar banorët e ndërtesës. Të fyer në sedër, ata ishin zotuar që ta rrihnin zotin A. A. (e quanin shpifës) në çastin e parë që do ta shihnin. Po ashtu, ndaj këtij artikulli kishte reaguar edhe gazeta kundërshtarë, që dilte nga shtypi herë pesë minuta më vonë e herë pesë minuta më vonë se gazeta e artikullshkruesit të mëparshëm. Gazeta kundërshtarë, si për inat të së parës, e kishte vendosur shkrimin e saj pikërisht në faqen trembëdhjetë, të rezervuar për barsoletat që sillnin lexuesit e pasionuar pas tyre. Zotërinjtë e kësaj të përditshmeje ndanin bindjen se zoti R. R. ishte pak i rëndësishëm dhe jo autor aq i pa vënë re, siç pretendonte gazeta tjetër. Ata thoshin se ky autor nuk ishte aspak pervers siç pretendonin kundërshtarët e tyre. Madje, sipas tyre, ai, në raste të caktuara, kishte dhënë edhe shembuj të një maturie të pakundshoqe. Ai ishte më shumë i dhënë pas disa veprimeve, që më shumë ishin shenja të autorëve që shesin imazh prej të veçantit, që më shumë sesa me vepër, kanë dëshirë të duken si të veçantë me jetën e tyre. Zotit R. R. i ishte fiksuar të ndiqte pëllumba. Kudo e kurdo i shihte, vraponte pas tyre. Edhe pse kishte një koleksion pëllumbash në shtëpinë e tij, ai nuk ndalej së

kërkuari lloje të tjera të këtij shpendi. Sipas burimeve të kësaj gazete, një pëllumb kishte hyrë brenda ndërtesës dhe zoti R. R., duke e ndjekur atë, kishte gjetur vdekjen e pame-rituar. Një vdekje e tillë e një autori, çfarë ishte ai, ishte tërësisht e panevojshme, përfundonte gazeta kundërshtarë. I menjëhershëm ishte reagimi i gazetës së zotit B. B., duke e mohuar një mënyrë të tillë vdekjeje. Kjo gazetë ngulte këmbë se pëllumbat nuk hyjnë në hyrje ndërtesash dhe burimet e gazetës kundërshtarë, si gjithnjë, janë çdoherë të pasakta.

Hamendësimet dhe debatet e të dy gazetave vazhduan edhe më tutje, por ne është e udhës t'i kthehemi personazhit plan-gprishës të novelës së lënë në gjysmë të zotit R. R. Ai jo që nuk i respektonte personazhet e tjera, por disa herë ia kishte kthyer fjalën edhe autorit të novelës. Si arrogant që ishte, tri herë e kishte sharë me rob shtëpie zotin R. R., krijuesin e tij. Të sharët do t'ia bënte hallall, por dy herë kishte tentuar të ikte nga novela dhe të mos kthehej më aty "derisa të ketë qiell mbi tokë", siç shprehej personazhi I. I., fjalë të cilat autori e kishte urdhëruar të mos i përdorte. Por, ja që ky nuk e dëgjonte dhe ia thoshte sy më sy, se ai si autor skematik që ishte, që mësuar me personazhe të dëgjueshme, por që tek ai do t'i haste sharra në gozhdë.

Në dy tentimikjet ky personazh edepsëz e kishte shfrytëzuar lodhjen dhe përgjumjen e autorit dhe kishte dalë jashtë faqeve të shkapërderdhura të novelës. Fatmirësisht, autori ishte

kthjellur dhe e kishte zënë ende pa dalë nga studioja e tij. Megjithatë, i parespektuari I. I. ishte betuar se do ta gjente një shtegdalje dhe do të ikte sa më parë nga novela e tij e shpifur. Zoti R. R. S'e kishte marrë aq seriozisht betimin e personazhit dhe kishte dalë për të blerë cigare në shitoren më të afërt. Kaq i kishte mjaftuar të paskrupullit I. I., që të ikte përfundimisht nga novela. E treta e vërteta, siç thuhet shpeshherë. Personazhi ua kishte mbathur këmbëve me vrapin e tij më të shpejtë, duke ikur sa më larg studios së autorit.

Zoti R. R. u kthye shpengueshëm në shtëpinë e vet. Me një ngadalësi të pacenueshme e hoqi pallton dhe hyri në studion e tij. Ç'të shihte?! Personazhi I. I. kishte ikur nga novela. E veshi pallton dhe doli me vrap nga shtëpia e tij. I mbushur vrer, u nis në drejtim të vendit ku do të fshihej krijesa e tij. Zoti R. R. e dinte saktë vendfshehjen sepse ai ishte krijuesi i tij.

Hyri në banesën ku ndodhej plangprishësi I. I. dhe me ta parë ia dha një shuplakë të nxehtë personazhit të vet. Duke pasur respekt për moshën, ky i fundit nuk ia ktheu. Autori e shtrëngoi dhe prerazi e urdhëroi që të kthehej në novelën e tij.

- Nuk kthehem më në atë novelë kotil, - ia priti pa një pa dy personazhi i tij.

- Ti je krijesa ime!, - i bërtiti autori. - Ti duhet t'i zbatosh urdhrat dhe kërkesat e mia!

- Përpos që je autor mendjeshkurtër, ti qenke edhe diktator!

- Kush mendon se je që më quan kështu, a?! Një personazh

episodik i një novele të pabotuar, asgjë më shumë.

- Kush mendon se je ti për të më futur në probleme dhe situata kotil?! Kush mendon se je ti që më fut në telashe, për të cilat nuk di të ofrosh zgjidhje?!

- Ore çun, ti a nuk kupton apo nuk dëshiron të kuptosh? Unë jam autori dhe e kam të drejtën të të fus ku të dua. Unë jam autori dhe kam të drejtën të të fus në telashe. Po të dua mund të të ofroj zgjidhje, e po të mos dua edhe nuk të ofroj. Unë jam autori! A kupton tash?

- Ti je autori, por ti nuk mendon aspak për atë që e krijon dhe për ngjarjen që e ndërton.

- Ti nuk ke të drejtë të mendosh. Ti duhet vetëm të veprosh! Zaten, për atë je i vendosur aty.

- Ti je autor që nuk di të mendosh. Si mund të më lidhësh mua me zonjushën S. S. kur mua më përshtatet më shumë zonjusha D. D.?

- Këtu është filli i gjithë rrëfimit sepse duke qenë në lidhje dashurie me zonjushën S. S., ti e bën xheloz pretenduesin e saj, zotin M. M. Andaj, këtu fillon konflikti.

- Por, zoti M. M. nuk është i denjë për të pasur konflikt me mua.

- Atë e di unë.

- Në bazë të asaj që je duke e shkruar, ti do të më vrasësh me dorën e zotit M. M. sikurse ngjet në të gjitha romanet dhe novelat e tua, - i tha përvaishëm personazhi I. I.

- Ende nuk kemi ardhur te fundi. Megjithatë, ç'është një vdekje jotja në krahasim me një kryevepër që do të dalë prej saj, - ia priti ftohtë zoti R. R.

- Por, unë nuk dua të vdes! Së paku, jo në këtë moshë të re.

- Çfarë personazhi i pafytyrë je ti që nuk je në gjendje të sakrifikohesh për të mirën e artit?

- Çfarë autor koti je ti që shkruan vepra, përfundimin e të cilave mund ta kuptojnë edhe personazhet e tua? Shkurt, unë nuk dua të vdes!

- Unë vendosi për jetën dhe vdekjen tënde!

- Jo... joooo... joooo!, - i rrodhën lotët personazhit I. I., pas kësaj klithme revoltuese ndaj autorit.

- Unë jam zoti yt!

- Ti nuk je zoti im!, - reagoi sërish personazhi I. I.

- Eja, robi im! Eja të të bëj kurban për artin! Për brezat që do të vijnë!

- Kësaj radhe do t'i ndërrojmë rolet, zoti autor.

- Si po mendon, o engjëlli im, që do të ma shpëtosh novelën?

- Mendoj se në këto çaste duhet ta shpëtoj novelën nga ti.


- Si...?!, - pyeti i habitur autori.

- Në vend se të më vrasësh ti, do të të vras unë me dorën time.

Personazh I. I. e goditi me shqelma, aq sa kishte fuqi, autorin R. R. E grushtoi dhe e shqelmoi tri herë. Pasi e rrëzoi përtokë, e theri tri herë me thikë. Nuk u mjaftua me kaq, por e hodhi poshtë shkallëve si një gjë të parëndësishme.

Të dashur lexues a këndonjës, a si dreqin t'ju quajmë, në qoftë se rastësisht e keni lexuar këtë tregim deri këtu, dijeni se përfundimin e tij e keni në fillim. Në qoftë se e keni harruar apo nuk e keni kuptuar, lexojeni edhe një herë. Fundja, nuk është e turpshme që të mos kuptohet apo të harrohet fillimi, mes apo fundi i një tregimi.

(Marrë nga numri i 11-të i revistës "Akademia")



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Envert
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ramosi, Messi, Neymari apo Mbappe: Kush do t'i gjuajë penalltitë te PSG-ja?

PARIS, 13 GUSHT - Ardhja e Lionel Messit te Paris Saint Germain ka shtuar shumë kualitet në ekipin e Mauricio Pochetinos, por trajneri argjentinas nuk do ta ketë lehtë në disa pika në gjithë këtë konkurrencë të madhe që ka në ekip. Një nga ato është se kush do t'i gjuajë penalltitë dhe gjuajtjet e lira. Kur jemi te penalltitë PSG-ja ka katër specialistë tashmë: Lionel Messi, Sergio Ramos,

Neymar dhe Kylian Mbappe. Të gjithë këta janë të saktë nga pika e bardhë dhe te të gjithë ekziston dëshira të vazhdojnë me këtë përgjegjësi. Nëse shikojmë dhjetë penalltitë e fundit të secilit, më i suksesshmi është treguar Ramosi, i cili nga dhjetë ka shënuar të gjitha. Neymar dhe Mbappe kanë shënuar nëntë, kurse befasisht Messi është më pak efektiv me

tetë nga dhjetë. Pra, duke e parë çfarë gare e ngushtë është, e vështirë që Pochetionon të zgjedhë. Pothuajse situatë e njëjtë është edhe me gjuajtjet e lira, të katërtit janë të mirë në këtë pjesë, por Sergio dhe Kylian janë një shkallë më poshtë. Se si do ta zgjidhë këtë trajneri mbetet të shihet, ndoshta do të lejojë që lojtarët të bëjnë marrëveshje mes vete.



Insignen pritët të largohet gjatë kësaj vere nga Napoli

MADRID, 13 GUSHT - Vazhdon të ketë raporte të përziera për Lorenzo Insignen, me Napolin që përpiqet të shesë tani për rreth 30 milionë euro, ndërsa thuhet që Atletico Madridi do të presë që ai të bëhet një lojtar i lirë verën e ardhshme. Kapiteni i Napolit nuk është aspak afër të pajtohet për një kontratë të re dhe marrëveshja

e tij aktuale skadon në fund të sezonit. Ai priste një rritje page pasi fitoi Euro 2020, ndërsa raportohet se Napoli dëshiron që ai të pranojë një shkurtim të konsiderueshëm nga paga e tij ekzistuese. Sipas gazetës spanjolle "Diario AS", Atletico Madridi i ka bërë me dije Insignes se janë të gatshëm të presin që ai të bëhet lojtar i lirë


dhe ta marrin verën e ardhshme. 30-vjeçari është në treg për 25-30 milionë euro, me Interin, Evertonin, Zenitin dhe Tottenhamin të interesuar për shërbimet e tij. Sipas "Corriere dello Sport", Insigne u tha shokëve të skuadrës së Napolit se ai do të mendojë seriozisht për një largim gjatë kësaj vere.



Dëmtohet Kessie, disa javë jashtë

Milano, 13 gusht - Dëmtim te Milani. Franck Kessie, një nga lojtarët më të rëndësishëm të kuqezinjve të Stefano Piolit, ka pësuar një dëmtim në seancën stërvitore të enjten. 24-vjeçari afrikan ka pësuar një tërheqje muskulore, që do ta mbajë disa javë jashtë fushave të blerta. Kessie humbet në këtë mënyrë

ndeshjet e para të kampionatit. Situatë që detyron Milanin të futet në merkato për të siguruar një qendërmesfushor. Pioli ka për momentin në dispozicion vetëm Bennacer dhe Tonalin në qendër të mesfushës. Kessie është pjesë e Milanit që nga viti 2017. Deri më tani ai ka bërë 184 paraqitje dhe ka shënuar 30 gola.



Edmond Azemi me portret gjigant në Prishtinë

PRISHTINË, 13 GUSHT - Basketbollisti i mirënjohur i Prishtinës, Edmond Azemi, është bërë me një portret gjigant në Prishtinë. Azemi, që i dha fund karrierës së luajtur në basketboll duke u pensionuar, është bërë me një portret të cilin është duke e sponsorizuar komuna e Prishtinës. Kjo është bërë në shenjë mirënjohje për basketbollin prishtinas që është edhe ikonë e këtij klubi me të cilin fitoi dhjetëra trofe. Pas pensionimit, Edmond mund ta ushtrojë pozitën e drejtorit sportiv në KB Prishtina.

Liverpooli e "blindon" Van Dijkun

Londër, 13 gusht - Virgil Van Dijk do të vazhdojë ta veshë fanellën e Liverpoolit deri në vitin 2025. Ai ka rinovuar kontratën me Redsat për katër sezone. Van Dijk është pjesë e Liverpoolit që nga janari i vitit 2018

kur u ble për 75 milionë funte. Për katër sezone ai ka fituar Champions Leaguen dhe Premierligën, derisa ka bërë 130 paraqitje. Van Dijk numëron edhe 13 gola me Liverpoolin. Vitin e kaluar bëri

vetëm tetë paraqitje, pasi humbi sezonin shkak i këputjes së ligamenteve, por tashmë është kthyer dhe i gatshëm për ta ndihmuar skuadrën e Jurgen Kloppit.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2020:132431
Datë: 15.07.2021
Numri i dokumentit: 02002245

C.nr.425/2020

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, i përbërë nga gjyqtari i vetëm **Betim Behluli**, në çështjen juridike të paditësit Adnan Kabashi nga fshati Xërxë, komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Musa Damati nga Mitrovica, kundër të paditurës Mlladenka Kabashi nga Bullgari, për shkak të zgjedhjes së martesës, me dt.15.07.2021, merr këtë:

AKTVENDIM

Të paditurës Mlladenka Kabashi nga Bullgaria, tani në adresë të panjohur, I CAKTOHET përfaqësuesi i përkohshëm avokate Arta Himaj nga Rahoveci.

Në kuptim të nenit 82 të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK), përfaqësuesi i përkohshëm i ka të gjitha të drejtat dhe detyrat e përfaqësuesit ligjor, të cilat i ushtron deri sa të paraqitet në gjykatë i padituri apo përfaqësuesi i tij me prokurë, gjegjësisht derisa organi i kujdestarisë ta njoftoj gjykatën se e ka caktuar kujdestarin.

Ky aktvendim do të shpallet në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, në një nga gazetatat e përditshme ditore, si dhe në tabelën e shpalljeve të gjykatës.

Arsyetim

Paditësi Adnan Kabashi nga fshati Xërxë, komuna e Rahovecit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i autorizuar avokati Musa Damati nga Mitrovica, kundër të paditurës Mlladenka Kabashi nga Bullgaria, tani me adresë të pa njohur jashtë Kosove, për shkak të zgjedhjes së martesës.

Gjykata ka caktuar seancën përgatitore me datën 05.07.2021, në të cilën për palën paditëse ka prezantuar i autorizuari i tij avokati Musa Damati Mitrovica, ndërsa nuk ka prezantuar e paditura Mlladenka Kabashi, nga Bullgaria, të cilës gjykata ftesën së bashku me të gjitha shkresat e lëndës i ka dorëzuar nëpërmjet rrugëve diplomatike respektivisht nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë, por gjykatës i është kthyer nota verbale me të cilën gjykata është njoftuar se në adresën e të paditurës Riina Tambet e njëjta nuk është duke jetuar në këtë adresë.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësit avokati Musa Damati ka deklaruar se: Mbetet në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, theksojë se për paditëse ka nevojë urgjente për të bërë zgjidhjen e martesës pasi që i njëjta është në prag të martesës dhe në pritje të lidhjes së martesës së re para organit kompetent dhe njëkohsisht ka të nevojshme që të ketë bashkim

familjar në vendin në të cilin jeton legalisht. Bazuar në këtë konsidero se janë përmbushur kushtet ligjore dhe i propozoi gjykatës që të caktojë një përfaqësues të përkohshëm në mënyrë që të procedojë me tutje dhe të arrijë sa më shpejt zgjidhjen e martesës në këtë çështje juridike.

Duke vendosur sipas propozimit të paditësit, gjykata gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 79.3 të LPK-së, për caktimin e përfaqësuesit të përkohshëm të të paditurës dhe se përfaqësuesi i përkohshëm avokatja Arta Himaj nga Rahoveci, është pajtuar që ta përfaqësojë të paditurën e lartcekur në këtë çështje juridiko - civile.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
C.nr. 425/2020, me datë 15.07.2021

Gjyqtari
Betim Behluli

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet ankesa në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit. Ankesa ushtrohet përmes kësaj gjykate, për gjykatën e Apelit, Divizioni Civil në Prishtinë.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “Villa Familjare -Villa Liqeni” SH.P.K. ka marrë vendim të shuaj biznesin me nr. 810109670 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Villa Familjare-Villa Liqeni” D.O.O, donelo odluku o prestani rada sa nr. 810109670, ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

All clients are to be informed that the “Villa Familjare-Villa Liqeni” L.L.C, has come to the decision to quit its nr. 810109670, the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ Talat Komoni shpall diplomën e shkollës së mesëm teknike “Nexhmedin Nixha”, Gjakovë, drejtimi Gjeodezi.
- ▶ Blerta Kryeziu, shpall të pavlefshme dëftesën e klasës së –XI- të shkollës së mesëm të mjekësisë “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- ▶ Ali Tahiri, shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesëm normale “Hysni Zajmi”, Gjakovë.
- ▶ Lëshoj banës me qira në lagjen “Dardania” në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokal me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- ▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales



PASHTETË PULË

MEKA
HALAL FOOD

gluten
free



100% mish pulë



cilësi e garantuar

pa konservues